

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6980
E hënë, 28 gusht 2023
Çmimi 0.40

Murtezaj: Ndërtimtaria dhe gastronomia, "prodhues" të punëtorëve pa letra



FACE 5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KA APO S'KA SIVJET ZGJEDHJE NË VERI?

FACE 4-5

AKTUALE



ZGJERIMI I BE-SË ME BALLKANIN PERËNDIMOR DHE PRETTIMI I HARRUAR I SELANIKUT F. 3

HETUESIT RUSË KONFRIMOJNË VDEKJEN E PRIGOZHINIT F. 2

KURTI MERR PJESË NË FORUMIN STRATEGJIK TË BLEDIT - BSF 2023 F. 6

EKONOMI



MËRGATA VAZHDON ME REKORDIN E REMITENCAVE, PËR SHTATË MUAJ U SOLLËN MBI 80 MILIONË EURO MË SHUMË NË KOSOVË F. 8

SPORT



LLAPI FITON ME PËRMBYSJE NDAJ FUSHË KOSOVËS, PRISHTINA MERR KRYESIMIN F. 10



Zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal besojnë se në aspektin procedural, zgjedhjet e parakohshme në katër komunit

me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq mund të mbahen gjatë këtij viti, por ndryshe mendojnë njohësit

e proceseve zgjedhore. Sipas tyre, gjasat janë reale që të mos këta fare proces zgjedhor këtë vit, por vetëm kah fillimi i vitit të ardhshëm

OSMANI: INTEGRIMI EVROPIAN ËSHTË E VETMJA RRUGË PËR KOSOVËN



KËRKOHET THEMELIMI I MINISTRISË SË FAMILJES

FACE 6

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani: Integrimi evropian është e vetmja rrugë për Kosovën

PRISHTINË, 27 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani Sadriu, ka udhëtuar për në Alpbach, Austri, për të marrë pjesë në edicionin e sivjetmë të Forumit Evropian Alpbach 2023.

Në këtë forum, presidentja Osmani ka qenë folëse në panelin kryesor në hapje të forumit, i cili është fokusuar në rishikimin e politikës aktuale të zgjerimit, adresimit të sfidave aktuale politike dhe të sigurisë, si dhe avancimin e Kosovës në rrugën drejt integritimit evropian. “Zgjerimi i Bashkimit

Evropian me shtetet demokratike të Ballkanit Perëndimor, mbrojtja e parimeve dhe vlerave të të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë, si dhe unifikimi në luftimin e autokracive e tiranive, janë tiparet që e bëjnë një Evropë të guximshme”, ka thënë Osmani, duke shtuar se pavarësisht se është rrugë e gjatë dhe e mundimshme, integrimi evropian është e vetmja rrugë për Kosovën. “Familja euroatlantike është familja jonë”, është shprehur Osmani. Gjatë forumit, presidentja

Osmani ka realizuar edhe një bashkëbisedim me të rinjtë bursistë të Forumit Evropian nga rajoni, diaspora dhe bota, me fokus në zhvillimet e fundit në vend, por dhe qëndrimin e Kosovës karshi zhvillimeve politike në Evropë dhe përtej. Forumi Evropian Alpbach është ndër institucionet më prestigjioze në Evropë, i cili nga viti 1945, mbledhë çdo vit liderë, nobelistë, akademikë, shkencëtarë dhe personalitete të ndryshme nga mbarë bota për të diskutuar idetë për një Evropë më të fortë dhe më demokratike.



Zelensky parashikon një “shtator të fuqishëm” për Ukrainën



KIEV, 27 GUSHT - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, tha se pret “një shtator të fuqishëm për Ukrainën”, përfshirë edhe vendime kyçe nga aleatët perëndimorë sa i përket furnizimit të Kievit me armë dhe pajisje të rëndësishme.

Kjo deklaratë e Zelenskyt erdhi disa orë pasi në mbarë Ukrainën u lëshuan alarmet paralajmëruese për sulme ajrore ruse dhe më pas autoritetet njoftuan se kanë shkatërruar disa raketa lundruese të Moskës.

Përmes një postimi në Telegram, Zelensky tha se pret që në javët në vijim të arrijnë “paketat e reja të mbrojtjes për ushtarët ukrainas”. “Artileri, autoblinda, sisteme të mbrojtjes ajrore dhe raketa dhe pajisje të nevojshme”, shkroi ai. “Partnerët tanë janë informuar për nevojat tona. Ne po presim që ata të marrin vendime”, shtoi presidenti ukrainas. Sipas Zelenskyt, një botë e bashkuar “është më e fortë se çdo agresor. Në shtator, ne do të jemi më të bashkuar”.

Njoftimi i Zelenskyt erdhi disa orë pasi ushtria ukrainase tha se ka shkatërruar katër raketa lundruese ruse. Autoritetet në Kiev thanë se kanë shkatërruar të gjitha raketat e nisura drejt kryeqytetit ukrainas.

Ushtria ukrainase tha po ashtu se po vazhdon kundërofensivën në Melitopol në rajonin e Zaporizhjes. Ky qytet i rëndësishëm, u mor nga Rusia pak kohë pasi Moskë nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurtin e vitit të kaluar.

Hetuesit rusë konfirmojnë vdekjen e Prigozhinit

MOSKË, 27 GUSHT - Vdekja e Yevgeny Prigozhin, kreut të grupit mercenar Wagner, është konfirmuar nga analizat gjenetike, tha Komiteti Hetues i Rusisë më 27 gusht.

Prigozhin vdiq gjatë rrëzimit të një avioni privat në veri të Moskës më 23 gusht. “Sipas këtyre rezultateve, është përcaktuar identiteti i dhjetë viktimave dhe korrespondojnë me listën e pasagjerëve të paraqitur të fluturimit”, tha komiteti.

Autoritetet ruse kanë thënë se në listën e pasagjerëve të avionit që u rrëzua ishte Prigozhin dhe komandanti i Wagner-it, Dmitry Utnik. “Ekzaminimet molekulare-gjenetike kanë përfunduar si pjesë e hetimit për rrëzimin e avionit në rajonin Tver”, tha zëdhënësjja e komitetit, Svetlana Petrenko.

Avioni privat Embraer ishte nisur nga Moskë drejt Shën

Petersburgut. Shkaku i rrëzimit të tij ende nuk është përcaktuar.

Një ditë pas rrëzimit të avionit, presidenti rus, Vladimir Putin, konfirmoi tërthorazi vdekjen e Prigozhinit, pasi i shprehu ngushëllime familjes së liderit të grupit mercenar. “Ai [Prigozhin] ishte njeri i talentuar”, tha Putini më 24 gusht, duke e quajtur “tragjedi” rrëzimin e avionit.

Ka pasur spekulime se Kremli mund të ketë qenë i përfshirë në rrëzimin e avionit. Avioni u rrëzua saktësisht dy muaj pasi Wagner kreu një rebelim të shkurtër kundër udhëheqjes ushtarake ruse.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, e ka përshkruar incidentin si “tragjik” dhe i ka quajtur “gënjeshtra” spekulimet për një përfshirje të mundshme të Kremlinit në këtë ngjarje.

Prigozhin, 62 vjeç, kreu një



rebelim jetëshkurtër ndaj liderëve ushtarakë rusë më 23-24 qershor. Luftëtarët e tij për një kohë të shkurtër morën nën kontroll qytetin jugor rus, Rostov-mbi-Don, dhe nisën marshimin drejt Moskës. Ata kërkuar largimin nga detyra të ministrit të Mbrojtjes, Sergei Shoigu, dhe shefit të Shtabit të

Përgjithshëm të ushtrisë ruse, Valery Gerasimov.

Rebelimi u zhvillua pasi për muaj të tëra Prigozhin akuzoi publikisht udhëheqjen ushtarake të Rusisë për strategjinë e luftës në Ukrainë, por edhe për mungesë të furnizimeve me municion.

Rebelimi paraqiti sfidën më

serioze ndaj presidentit Vladimir Putin, në dy dekadat e tij në pushtet.

Vendndodhja e Prigozhinit pas rebelimit ishte gjerësisht një mister. Ai besohet se ka lëvizur midis Rusisë dhe Bjellorusisë, ku trupat e Wagner-it kanë ngritur një kamp për të trajnuar forcat e armatosura bjelloruse, si pjesë e marrëveshjes së negociuar që i dha fund rebelimit.

Më 28 korrik, ai ishte fotografuar në margjinat e samitit Afrikë-Rusi të mbajtur në Shën Peterburg. Në këtë fotografi ai u shfaq duke u përshëndetur me presidentin e Republikës së Afrikës Qendrore.

Pas rebelimit, Putin e kishte akuzuar Wagner-in për “thikë pas shpine” dhe kishte konfirmuar se Qeveria ruse i kishte ofruar grupit mercenar mbi 1 miliard dollarë fonde gjatë viteve të fundit.

Zgjerimi i BE-së me Ballkanin Perëndimor dhe premtimi i harruar i Selanikut

Premtimi i BE për integrimin e Ballkanit Perëndimor, deri tani nuk është përmbushur. Kjo e nxit autokratët në rajon. Lufta kundër Ukrainës po bën edhe më të qartë, se sa i rëndësishëm është procesi i anëtarësimit

PRISHTINË, 27 GUSHT - Në verën e vitit 2003, përpara 20 vjetësh, krerët e shteteve de të qeverive të BE-së dhe të Ballkanit u takuan në afërsi të Selanikut. Ajo që qysh atëherë është bërë rutinë, asokohe ishte një sinjal i rëndësishëm. Vendet Ballkanit Perëndimor të karakterizuar nga lufta, shpërbërja e shtetit dhe regjimet autoritare, duhet ta kenë të ardhmen e tyre në BE. Ky premtim duhej të shënonte kalimin nga koha e pasluftës në një fazë të shpresës ndaj së ardhmes evropiane, por në fakt ndodhi ndryshe.

Problemet e rajonit nuk mund të zgjidheshin vetëm me premtimin për një anëtarësim të ardhshëm në BE. Si ndërmjetësuese rezultatet e BE-së ishin modeste. BE-ja nuk ia doli që Bosnjën dhe Hercegovinën t'i kthente në një shtet, që ka struktura funksionale, po ashtu nuk u arrit, që të kufizohej etnosocializmi shkatërrimtar. Edhe mbi dhjetë vjet të ndërmjetësimit në dialogun mes Serbisë dhe Kosovës nuk janë arritur suksese të qëndrueshme. Njëkohësisht nacionalizmi dhe revizionizmi historik janë sot më të theksuara se në vitin 2003. Shkurt, periudha e pasluftës i ngjan asaj të paraluftës.

Njëkohësisht edhe optimizmi në BE optimizmi është në rënie. Fillimisht dështoi një kushtetutë evropiane në referendumet në Francë dhe në Holandë. Që prej krizës ekonomike dhe financiare 2007/2008 BE-ja po has nga një krizë në tjetrën, aq sa me sa duket nuk mbetet kohë për plane ambicioze. Vetëm Kroacia ia ka dalë qysh atëherë që të anëtarësohet në BE. Për të gjashtë vendet e tjera, të cilëve iu ofrua anëtarësia atëherë, rruga vazhdon të mbetet e gjatë.

Ndërprerja e zgjerimit nuk ka qenë asnjëherë kaq e gjatë

Asnjëherë më parë që prej 50 vjetësh BE nuk e ka shtyrë kaq shumë ndërprerjen e procesit të zgjerimit. Që me anëtarësimin e Irlandës, Danimarkës dhe Britanisë së Madhe më 1973 ritmi i zgjerimit të BE-së ka qenë më pak se dhjetë vjet, kur janë pranuar vende të reja në grup. Por tani nga premtimi i Selanikut kanë kaluar 20 vjet, edhe që prej anëtarësimit të fundit, Kroacisë, kanë kaluar dhjetë vjet - dhe asnjë anëtar i ri nuk pritët në vitet e ardhshme,



Kjo ndërprerje e gjatë nuk është ndonjë gjë e papritur, sepse gjashtë vendet në Ballkanin Perëndimor vazhdojnë të presin ashtu si pret Turqia, Ukraina, Moldavia edhe Gjeorgjia. Por procesi nuk po avanco. Në Turqi përgjegjësia kryesisht rëndon ndaj presidentit autoritar Erdogan. Në Ballkanin Perëndimor ka po ashtu krerë autoritar shtetesh apo qeverish, që qëndrojnë në pushteti si Erdogani me taktikat e pushtetit ndërkohë që bëjnë vetëm fjalë boshe për anëtarësimin në BE. Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq ndjek më së shumti shembullin e Erdoganit, ruan marrëdhënie me Rusinë, me Turqinë si edhe me Kinën dhe me Shtetet e Gjirit Persik, për të mos qenë fort i varur nga Evropa.

Asnjë përgjigje ndaj përhapjes së autokratëve

Të tjerë autokratë, që nga burri i fortë i entitetit boshnjak, Reoublika Srpska, Milorad Dodik, e deri tek kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kanë raporte të ndryshme me BE-në, por të gjithë mund të jetojnë nën hijen e zgjerimit të BE-së. Disa si Dodik, pozicionohet si antiperëndimor duke provokuar, flirtojnë me Putinin dhe përpiqen që ta minojnë nga ana tjetër paqen në rajon. Të tjerë si Rama mbështeten tek BE, por abuzojnë me pushtetin e tyre personal. BE nuk ka ndonjë përgjigje ndaj përhapjes së autokracisë. Disa si

Dodik ndonjëse kritikohen mund të mbijetojnë dhe marrin jehonë jo vetëm nga Moska, por edhe brenda BE-së. BE shpesh kthehet në implikator për premtimet e dhëna afatshkurtër. Kryeministri Vuçiq ia del gjithmonë që të shitet si zjarrfikës, për të shuar zjarret që i ndez vet. Shpesh BE-ja në këtë rast kthehet në implikator, duke i mbyllur sytë ndaj sulmeve kundër lirisë së medias dhe autokratëve në Ballkanin Perëndimor.

BE-ja, nuk ka më bartës shprese

Anëtarësimi në BE dhe premtimi i kushtëzuar me shtetin ligjor dhe demokracinë ka kohë që nuk janë më tema përcaktuese. Për BE-në më rëndësi ka menaxhimi i krizave, përtej vlerave - qoftë për shkak të migracionit përmes këtij rajoni, qoftë edhe për të kufizuar influencën e Rusisë. Edhe në rajon BE-ja nuk konsiderohet më si bartës i shpresës. Në shumë demonstrata kundër shkatërrimit të mjedisit dhe dhunës dhe për demokracinë, që zhvillohen vazhdimisht jo vetëm në Serbi, nuk valëviten më flamujt e BE-së. BE-ja dhe vendet anëtare të saj kanë bërë pakte me autokratët, prej kohësh unioni nuk konsiderohet më simbol për një të ardhmen demokratike. Se si mund të shkojë më tej, këtë e kemi përkufizuar së fundi në grupin Balkans in Europe Policy Advisory Group (BIEPAG):

Zgjerimi i BE-së që nga viti 2022 nuk është më një proces vetëm për Ballkanin Perëndimor, por edhe për Ukrainën dhe Republikën e Moldavisë, si dhe potencialisht edhe për shtete si Gjeorgjia. Kjo i jep procesit sërish një rëndësi më të madhe politike. Kjo do të thotë, që shtetet duhet të kenë një të ardhme të planifikueshme në BE, pa abuzuar me të drejtën e vetos nga anëtarët e BE-së, si praktikohet nga Bullgaria në rastin e Maqedonisë së Veriut.

Heqje dorë prej konceptit të stabilokracisë

Për anëtarët e ardhshëm nevojiten edhe më shumë paratë e BE-së, në mënyrë që të zbuten dallimet në zhvillim mes anëtarëve të unionit dhe atyre vendeve që do të anëtarësohen. Demokracia dhe shteti ligjor duhet të mbeten në fokus të zgjerimit. Komisar i aktual i zgjerimit, Oliver Varhelyi, si krahu i zgjatur i Viktor Orbanit minon besimin e BE-së kundrejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe të Ukrainës. Për këtë duhet një komisar me më shumë peshë dhe me një background më të përshtatshëm. Gjithashtu BE nuk duhet që të vazhdojë të heqë dorë prej demokracisë në Ballkan për hir të një gjoja stabiliteti apo bashkëpunimi kundër Rusisë. Stabilokratët e rajonit, pra autokratët, që i shesin BE-së premtimin për stabilitet në këmbim të demokracisë, duhet

të demaskohen, e në radhë të parë presidenti serb Aleksandër Vuçiq.

Premtimi i Selanikut i rëndësishëm edhe për Ukrainën

Se sa e vështirë është kjo, e tregon fakti, që një bashkëautore e studimit tonë, Jovana Marovic, ish-ministre për Integrimin Evropian në Mal të Zi, më 23 gusht 2023 u arrestua në aeroportin e Beogradit dhe iu refuzua udhëtimi në Serbi. Ajo sipas autoriteteve serbe paraqiste "rrezik për sigurinë". Një praktikë e tillë ndaj politikanëve nga vendet fqinj të Serbisë nuk është e re - me këtë Vuçiq ka hapur një etapë të re përshkallëzimi, jo vetëm ndaj Malit të Zi, pavarësinë e të cilit Serbia nuk e ka pranuar asnjëherë, por edhe në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ka një sërë propozimesh të reja për metodat e zgjerimit, por në fund asnjëra nuk do të funksionojë, nëse mungon vullneti politik. BE-ja duhet të jetë e gatshme, që t'i pranojë shtetet e Ballkanit Perëndimor, nëse ato i plotësojnë kushtet. Nëse BE-ja nuk ia del, ta integrojë në union Ballkanin Perëndimor, atëherë tingëllon jo bindës edhe çdo premtim për anëtarësimin e Ukrainës. Shkurt, me këtë mënyrë rrezikohet shumë më tepër, se sa vetëm një premtim i vjetër para 20 vjetësh, që deri tani nuk është mbajtur. (DW)



Ka apo s'ka sivjet zgjedhje në veri?

Zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal besojnë se në aspektin procedural, zgjedhjet e parakohshme në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq mund të mbahen gjatë këtij viti, por ndryshe mendojnë njohësit e proceseve zgjedhore. Sipas tyre, gjasat janë reale që të mos këta fare proces zgjedhor këtë vit, por vetëm kah fillimi i vitit të ardhshëm

PRISHTINË, 27 GUSHT - Drafti i udhëzimit administrativ, që u mundëson qytetarëve të komunave të Kosovës shkarkimin e kryetarëve të tyre përmes peticionit, është paralajmëruar se do të dalë në diskutim publik më 26 gusht, thonë zyrtarë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Një dokument i tillë vjen në kohën kur Bashkimi Evropian është duke i kërkuar me ngulm Kosovës që të shpallë zgjedhje të reja në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Këto komuna aktualisht

udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë. Ata kanë dalë nga zgjedhjet e prillit, të cilat janë bojkotuar nga popullata shumicë serbe. Por, marrja e detyrës nga ta ka tensionuar situatën në veri qysh në fund të majit, kur banorët lokalë kanë nisur të protestojnë kundër tyre. Zgjedhjet e reja tani shihen si mënyrë për shtensioimin e situatës. Për më tepër, ato janë edhe obligim që dalin nga një marrëveshje mes zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe të dërguarit të BE-së për dialogun Kosovë-Serbi,

Miroslav Lajçak, për këtë qëllim. Zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal besojnë se në aspektin procedural, zgjedhjet e parakohshme në këto komuna mund të mbahen gjatë këtij viti, por ndryshe mendojnë njohësit e proceseve zgjedhore.

Murtezani: Udhëzimi administrativ i gatshëm më 1 shtator

Besim Murtezani, zëvendësudhëheqës i Departamentit ligjor dhe monitorimit të komunave në

kuadër të MAPL-së, thotë për Radion Evropa e Lirë se diskutimi publik për udhëzimin administrativ do të zgjasë deri më 31 gusht. "Të enjten [31 gusht] e kemi takimin e fundit të grupit punues dhe ai do t'i përfshijë sugjerimet dhe vërejtjet prej diskutimit publik dhe [pastaj] do të bëhet drafti përfundimtar, në mënyrë që të premtën, më 1 shtator, t'i dërgohet ministrit për nënshkrim", thotë Murtezani. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka deklaruar qysh më herët se udhëzimi administrativ do të jetë gati më 1 shtator.

Rregullat procedurale thonë se pas nënshkrimit nga ministri, do të duhen shtatë ditë që udhëzimi administrativ, pas daljes në Gazetën Zyrtare, të hyjë në fuqi.

Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, qytetarët e katër komunave në

veri të Kosovës mund ta iniciojnë menjëherë peticionin për largimin e kryetarëve aktualë të atyre komunave.

Sipas Murtezanit, kohëzgjatja e mbledhjes së nënshkrimeve në peticion është 45 ditë që nga iniciimi i peticionit, por procesi mund të kryhet edhe më shpejt, nëse arrihet mbledhja e 20 për qind të nënshkrimeve të votuesve nga iniciuesit e peticionit.

Më pas, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron Murtezani, verifikon nënshkrimet e votuesve dhe organizon votimin në komunën ose komunat që kanë iniciuar peticion.

Për shkarkimin e kryetarit të një komune nevojiten 50 për qind plus 1 votë nga numri i përgjithshëm i votuesve të komunës përkatëse.

Në rast se rezultati i votimit kërkon shkarkimin e kryetarëve, atëherë ai i dërgohet presidentes së

Serbia nuk po zbaton marrëveshjet, pak shqiptarë në institucionet shtetërore në Luginë

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ish-kryetarja e Komunës së Preshevës, Ardita Sinani ka akuzuar Serbinë se nuk ka zbatuar qëllimet thelbësore të marrëveshjeve, siç janë integrimi, rimëkëmbja e shpejtë ekonomike, kthimi i popullatës së zhvendosur dhe çmilitarizimi i rajonit nga ana e njësive speciale të sigurisë. Sinani ka shkruar në "Facebook" se krahas obligimeve kushtetuese dhe

ligjore, si dhe obligimeve të cilat imponohen nga marrëveshjet tanimë të njohura ndërkombëtare; Serbia ka marrë ndaj Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës edhe obligime të posaçme me tri dokumente të veçanta, të cilat janë miratuar nga ana e qeverisë. "21 vjet më vonë, në të gjitha institucionet që nuk janë nën kompetenca të Komunave (që janë në kompetenca të Qeverisë

Republikane ose Administratës së Rajonit), numri i shqiptarëve është simbolik, e ka madje institucione ku nuk ka fare shqiptarë. Jo vetëm që nuk janë punësuar shqiptarët lokalë, por janë sjellë edhe serbë të rajoneve të tjera nga Serbia", ka shkruar ajo.

Sinani e cila tani është këshilltare e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti ka theksuar se kjo është Serbia për pakicat e saj kombëtare.



Kërkohet themelimi i Ministrisë së Familjes

PRISHTINË, 27 GUSHT - Shoqëria civile kërkon nga Qeveria e Kosovës të formojë Ministri të Familjes, në të cilën do t'i kushtohet kujdes më i madh grave të papuna që kujdesen për fëmijët, kujdesi ndaj të moshuarave e personave me aftësi të veçanta. Derisa thonë se kjo praktike përdoret në shtetet e zhvilluara, ata shtojnë se Ministria e Familjes do të ndihmonte në politika edhe për rritjen e natalitetit.

Kryetari i Lëvizjes qytetare "Demokracia konservatore", Abdullah Klinaku, tha se marrë parasysh vështirësitë që po kalojnë familjet në Kosovë, Ministria e Familjes do të hartonte politike për një jetesë të dinjitetshme.

Sipas tij, një propozim konkret është subvencionimi i nënave të papuna të cilat kujdesen për fëmijët. "Duke pas parasysh rrethanat të cilat po kalon familja shqiptare në përgjithësi, një agjendë që herë pas herë po zhvillohet kundër familjes, migracionin e madh, gjendjen e rëndë ekonomike, sfidat në shëndetësi, arsim, besoj se janë një tërësi e instrumenteve që po e vështirësojnë qëndrueshmërinë stabile të familjes në Kosovë. Në këtë



segment, marrë parasysh edhe çështjen e çerdheve ku është numri i vogël, ku është pamundësia e dërgimit në çerdhe private të fëmijëve prej familjeve që nuk kanë qëndrueshmëri ekonomike, atëherë ne duhet të mendojmë domosdoshmërisht për një tërësi mekanizmave të cilët do e lehtësojnë qëndrueshmërinë

e familjes tonë. Në këtë segment një prej propozimeve është subvencionimi i familjeve, përkatësisht i nënave që kanë 3 fëmijë e më shumë, të ketë një subvencionim afatgjatë, në vlerën e një page minimale për periudhën e kohës sa ato përkujdesen për fëmijët", u shpreh Klinaku. Derisa rendit argumentet pse

duhet të formohet Ministria e Familjes, Klinaku shton se praktika të tilla përdorin vende të ndryshme të botës.

Sipas tij, subvencionimi i grave që vendosin të kujdesen për fëmijët do të ndihmonte edhe në rritjen e natalitetit në Kosovë.

Edhe Besa Luzha, profesoreshë dhe aktiviste për të drejta të

njeriut, konsideron se formimi i Ministrisë së Familjes do të ndihmonte që të vlerësohej përmes subvencionimit edhe gratë që kujdesen për fëmijët. Formimi i Ministrisë së Familjes është i nevojshëm edhe në sytë e ekonomistit Mustafë Kadriaj, që thotë se mund të ndikojë në rritjen e natalitetit. (ksp)

Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat ligjor prej 30 deri në 45 ditë për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Cakolli: S'ka gjasa për zgjedhje sivjet

Eugen Cakolli, nga Instituti Demokratik i Kosovës, thotë se të gjitha këto procedura marrin kohë dhe vështirë se mund të përfundojnë deri në fund të muajit nëntor.

"Petitioni, pastaj të gjitha afatet tjera që duhet të rrjedhin, si dhe mbajtja e procesit të votimit nga ana e KQZ-së, pra, vetëm për largimin e kryetarëve... këto procedura na sjellin neve deri të muaji nëntor së paku, nëse jo edhe më gjatë se kaq".

"Shpallja e zgjedhjeve të reja sërish merr 30 deri në 45 ditë. Përveç kësaj, ka afat të ankesave... Gjasat janë reale që ne, potencialisht, të mos kemi fare proces zgjedhor këtë vit, por vetëm kah fillimi i vitit të ardhshëm. Por, edhe kjo, vetëm nëse ndërkohë nuk ka zhvillime të reja", thekson Cakolli.

Murtezani, në anën tjetër, shprehet i bindur se, në rast se fillohet menjëherë me zbatimin e procedurave, zgjedhjet mund të mbahen këtë vit. Por, sipas tij, kjo nuk varet vetëm nga aspekti procedural. "Kjo më shumë ka të bëjë me vullnetin e qytetarëve. Ka komunë që mund ta nisë iniciativën [për petitionin] më herët ose më

vonë", thotë ai.

Mbajtja e zgjedhjeve "varet nga gatishmëria për mbledhjen e nënshkrimeve"

Ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, thotë se mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës nuk do të varet me automatizëm vetëm nga zbatimi i përpiktë i afateve të procedurave. "Unë jam skeptik që sivjet do të mund të shkohet në zgjedhje. Ka edhe një moment politik, përveç aspektit procedural, për të cilin po flasim. Pra, kujt i konvenon status quo-ja dhe

drejtimi i gishtit [të fajësimit] kah Prishtina. Nëse i konvenon [presidentit serb, Aleksandar] Vuçiq dhe Listës Serbe [partisë më të madhe të serbëve në Kosovë], do të marrë kohë edhe më shumë, sepse ata që e kanë bojkotuar sistemin, do të jenë të njëjtit që do t'i grumbullojnë nënshkrimet për petition. Ne nuk e dimë se a janë ata të gatshëm ta bëjnë një gjë të tillë", thotë Ferati.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, në zgjedhje të parakohshme për kryetar të komunës mund të shkohet në rast se kryetari aktual jep dorëheqje; në rast se qytetarët kërkojnë shkarkimin e kryetarit të komunës përmes një petitioni të nënshkruar

nga 20 për qind e votuesve të komunës përkatëse, si dhe në rast se kryetari i komunës nuk paraqitet në vendin e punës më shumë se një muaj, pa arsye.

Ndonëse dorëheqja eventuale e kryetarëve të katër komunave në veri të Kosovës do t'i përshpejtonte procedurat e shkuarjes në zgjedhje të jashtëzakonshme, autoritetet e Kosovës kanë theksuar se nuk do t'ua kërkojnë këtë gjë kryetarëve aktualë.

Sipas tyre, zgjedhjet në këto komuna mund të mbahen vetëm pas shkarkimit të kryetarëve aktualë përmes petitionit të nënshkruar nga 20 për qind e votuesve të secilës prej këtyre komunave.

Qeveria e Kosovës abuzoi me besimin e ShBA-së



Uashington, 7 qershor - Grindja me amerikanët i dëmton interesat e Kosovës. Kështu ka thënë ish-ndihmës i sekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Fried.

Sipas tij, SHBA-ja nuk ka qenë kurrë kaq e zemëruar me Qeverinë e Kosovës dhe një gjë e tillë është "mjafat shqetësuese".

Kryeministri Albin Kurti dhe ekipi i tij "e kanë marrë mbështetjen amerikane si të mirëqenë. Ata kanë abuzuar me besimin amerikan në atë mënyrë që do të jetë e vështirë për ta që ta rregullojnë", ka thënë Fried në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë".

Reagimi vjen pas kritikave të ashpra që bëri i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në adresë të Kurtit, të cilin e ka fajësuar për mungesë bashkëpunimi në shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

Tensionet në këtë pjesë të vendit, të banuar me shumicë serbe, janë të larta qysh më 26 maj, kur kryetarët shqiptarë të komunave kanë marrë detyrën, përkundër rezistencës së banorëve lokalë.

Zoti Fried, i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ishte shumë kritik ndaj Qeverisë së Kosovës për situatën e tensionuar në veri të vendit. Ai e kritikoi kryeministrin Albin Kurti për mungesë bashkëpunimi në uljen e tensioneve. Kurti, në anën tjetër, këmbëngul se nuk mund të bëjë kompromise për "republikën demokratike". Cili është komenti

juaj?

Daniel Fried: Është e qartë që Kosova është duke i injoruar shqetësimet e Shteteve të Bashkuara dhe duke vepruar në një mënyrë që ne nuk e inkurajojmë. Unë kurrë nuk e kam parë administratën e SHBA-së kaq të zemëruar me Qeverinë e Kosovës, jo në këta 15 vjet që nga shpallja e pavarësisë.

Qeveria amerikane i ka inkurajuar kosovarët që të mos e bëjnë këtë problem në veri dhe kosovarët na kanë injoruar. Dhe, rezultatet janë pikërisht ato për të cilat i kemi paralajmëruar. Unë nuk kam dyshim në supozimet e mia. Përndryshe nuk mund ta shpjegoj se përse ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, dhe Gabriel Escobar do të ishin aq të irrituar. Unë supozoj se ata i kanë arsytet e tyre. Unë supozoj se arsytet e tyre bazohen në injorimin që u bëri Kurti paralajmërimeve të tyre dhe në të konsideruarit e mbështetjes së ShBA-së si të mirëqenë – çfarë ka qenë gabim dhe e habitshme.

Ai (Kurti) e ka bërë presidentin e Serbisë, (Aleksandër) Vuçiq të duket empatik. Nuk kam menduar se kjo është e mundur, marrë parasysh se serbët janë burim i problemit, sepse janë ata që refuzojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës dhe refuzojnë ta njohin realitetin se Serbia nuk do ta ketë më kurrë (Kosovën). Por, pavarësisht kësaj, Kurti ka arritur t'i dëmtojë marrëdhëniet me SHBA-në për asnjë interes që unë mund ta identifikoj. Është mjafat

shqetësuese. Unë nuk e kam parë kurrë Qeverinë amerikane kaq të zemëruar me Qeverinë e Kosovës.

Pra, mendoni se Kurti po shkon shumë larg në rrethanat aktuale... Daniel Fried: Po, mendoj se ka bërë gabim në gjykimet. Ai e definon sovranitetin e Kosovës në atë mënyrë që e bën të ndihet se mund të kërkojë asgjë tjetër, përveç maksimumit. Dhe, duke vepruar kështu, ai e ka bërë situatën e keqe edhe më të keqe.

Escobari, duke folur për masat kundër Kosovës nëse Kurti nuk është konstruktiv, tha se ShBA-ja "nuk mund të planifikojë asgjë për Kosovën"... Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Daniel Fried: Mendoj se ai po shpreh zhgënjimin e administratës [amerikane] me Kurtin dhe po e bën të qartë se Kurti dhe ekipi i tij e kanë marrë mbështetjen amerikane si të mirëqenë. Ata kanë abuzuar me besimin amerikan në atë mënyrë që do të jetë e vështirë për ta që ta rregullojnë, por më mirë të nisim e ta bëjmë një gjë të tillë. E përsëris, burimi afatgjatë i problemit në marrëdhëniet Kosovë-Serbi vjen nga Beogradi, nga revanshizmi serb, ndërsa Kurti ka arritur të grindet me ShBA-në. Grindja me amerikanët i dëmton interesat e Kosovës në atë mënyrë që unë s'e kuptoj. Unë nuk e di se çfarë ka menduar ai (Kurti).

Escobari, po ashtu, e ka bërë të qartë se kjo situatë nuk ka të bëjë me popullin e Kosovës, por me një

individ, duke aluduar te Kurti. Ku po e dërgon Kurti Kosovën?

Daniel Fried: Do të ishte më mirë që Kurti të ndërmernte një hap prapa dhe të gjente një mënyrë që do t'i riparonte raportet me ShBA-në. Çdo drejtim tjetër mund të bëhet shumë më i kushtueshëm. Nuk e di se çfarë mbështetjeje ka brenda Kosovës, nëse shihet si ai që i ka thyer marrëdhëniet me ShBA-në, e cila, para së gjithash, ishte e para në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës dhe sigurisë në Kosovë.

Shumë në Kosovë pyeten se pse vetëm Kosova ndëshkohet, jo Serbia...

Daniel Fried: Kjo ka të bëjë, sipas të gjitha gjasave, me besimin e keq në Qeverinë e Kosovës. E thashë, burimi themelor i problemit është në Beograd. Që Shtetet e Bashkuara të jenë aq të zemëruara me Qeverinë e Kosovës, këtu duhet të ketë ndodhur një akt i keqbesimit. Nuk e di me siguri, por është supozimi im.

Si do ta vlerësonit qasjen e administratës amerikane ndaj Kosovës dhe Serbisë?

Daniel Fried: Mendoj se para këtij shpërthimit të fundit, SHBA-ja e konsideronte problemin në Beograd dhe besonte se kosovarët, gradualisht, mund të dilnin në një gjendje relativisht të mirë. Por, asaj i duhet një partner në Kosovë për ta ndihmuar në stabilizimin e veriut. Mendoj se administrata amerikane ndjen se nuk e ka atë partner tani.

A mendoni se situata në veri mund të ketë një ndikim më të gjerë në rajon?

Daniel Fried: Sigurisht. Nuk ka asgjë të mirë që del prej kësaj. Do të ishte keq nëse çon në një konflikt të hapur, mendoj në përshkallëzim të tensioneve ose përshkallëzim të luftimeve dhe vdekje. Mendoj se Kurti duhet të veprojë shpejt për të vendosur së paku një marrëdhënie pune me administratën amerikane. Njerëzit bëjnë gabime. Këshilla ime do të ishte që t'i rregullojë ato, por nuk e di nëse jemi ende në atë pikë.

Sa përfiton aleatja e Serbisë, Rusia, nga kjo situatë?

Daniel Fried: Shumë. Ky është një lajm i mirë, i mirëpritur për Kremlinin dhe (ministrin e Jashtëm rus, Sergei) Lavrovin. Atyre u pëlqen t'i shohin Shtetet e Bashkuara duke u grindur me Kosovën. Do të jenë oportunistë dhe do ta shfrytëzojnë.

Çfarë do t'i sugjeroni Kurtit të bënte?

Daniel Fried: Të gjejë një mënyrë për të biseduar me Shtetet e Bashkuara pa zhurmë dhe të gjejë një mënyrë për t'u larguar nga ky konfrontim.

Përfundon transferimi i ushtarëve turq në Kosovë

Prishtinë, 7 qershor - Ka përfunduar transferimi i një batalioni komando pas kërkesës së Komandës së Forcës së Përbashkët të NATO-s. Një pjesë tjetër e batalionit komando të Komandës së Brigadës 65 të Mekanizuar të Këmbësorisë e

vendosur në rrethin Luleburgaz të qytetit Kirklareli, e cila ishte caktuar si njësi rezervë, ka mbërritur në aeroportin ushtarak në Çorlu. Ushtarët turq pas përgatitjes në këtë vend, me avionë ushtarakë janë nisur drejt Aeroportit Ndërkombëtar

"Adem Jashari" në Prishtinë. Ushtarët janë pritur nga ambasadori turk në Prishtinë, Sabri Tunç Angli, ndërsa më pas kanë kaluar në kazermën "Sulltan Murat".

Rritja e numrit të ushtarëve të NATO-s në Kosovë vjen pas tensioneve në veri të vendit.



Kurti merr pjesë në Forumin Strategjik të Bledit - BSF 2023

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Bled të Sllovenisë për të marrë pjesë në Forumin Strategjik të Bledit - BSF

2023. Zyra e kryeministrit ka njoftuar se në kuadër të pjesëmarrjes së tij në këtë forum, Kurti ka marrë pjesë në darkën e punës së ftuar nga kryeministri i Republikës së Sllovenisë,

Robert Golob, ndërkaj të hënën do të jetë pjesë e një paneli të diskutimit së bashku me liderë të rajonit, si dhe do të zhvillojë disa takime bilaterale.



Kadrijaj: Vendimi për mospagimin e librave për nxënësit po e rëndon buxhetin familjar të prindërve



Prishtinë, 27 gusht- Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Time Kadrijaj, ka reaguar lidhur me vendimin e Ministrisë së Arsimit që t'i subvencionojë prindërit për blerjen e teksteve shkollore për nxënësit.

Sipas saj, vendimi për mospagimin e librave për nxënësit në këtë fillim vit po e rëndon buxhetin familjar të prindërve, të cilët kanë më shume se një fëmijë. "Kjo qeveri kur është në pyetje interesi i qytetarëve nuk ka vendimmarrje dhe vonohen në vendime, kështu ata edhe më shume po e komplikojnë

jetën e qytetarëve. Po sa efikase dhe sa e sigurt është që kush aplikon në platformën e-Kosova a do funksionoj dhe a do rimbursohen mjetet, apo ky është një mashtrim i radhës për blerje të kohës që ndoshta prindërit asnjëherë nuk do i marrin këto mjete", ka shkruar deputetja në "Facebook".

Kadrijaj tutje ka thënë se duhet kujdes i shtuar në plotësimin e aplikacionit se "deputetët e VV-së ju kanë kërcënuar!". "Qeveri e turpër dhe për faqe të zezë!", ka përfunduar ajo.

Murtezaj: Ndërtimtaria dhe gastronomia, "prodhues" të punëtorëve pa letra

PRISHTINË, 27 GUSHT - Automatizimi i procesit të punës në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) ka bërë që asnjë tatimpagues të mund të pretendojë se mundet t'i anashkalojë apo vonojë pagesat e detyrimeve tatimore, thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ushtruesi i detyrës së drejtorit ekzekutiv të ATK-së, Ilir Murtezaj.

Ky automatizim, sipas tij, ka bërë që të rritet përmbushja e obligimeve tatimore në mënyrë vullnetare, ndonëse mbeten sfidë borxhet e vjetra në vlerë të rreth 500 milionë eurove. "Një nga sektorët, apo çështjet që është identifikuar si risk në informalitet, është pjesa e punëtorëve të padeklaruar. Ne edhe në të kaluarën kemi

monitoruar këtë proces, mirëpo tashmë kemi projekt specifik për punëtorë të padeklaruar. Vetëm gjatë këtij viti janë identifikuar rreth 1.360 punëtorë të padeklaruar, apo që nga fillimi i projektit kemi identifikuar mbi 7.000 punëtorë të padeklaruar. Përveç këtyre rezultateve, të dhënat tjera tregojnë se në vazhdimësi po ka rritje. Nga muaji në muaj, ka raportime të reja nga punëdhënësit, të cilët raportojnë për punëtorë përmes deklaratave të mbajtjes së deklarimit në burim. Vetëm gjatë këtij muaji i kemi rreth 15 mijë punëtorë më shumë se në korrikun e vitit 2022. Mund të themi se disa nga ta janë edhe për shkak të rritjes së punësimit, por disa janë edhe rezultat i formalizimit", ka deklaruar Murtezaj.



I pyetur se cili sektor ka më tepër punëtorë të padeklaruar, Murtezaj ka theksuar se sektori i ndërtimtarisë dhe sektori i gastronomisë kanë më tepër punëtorë të padeklaruar. "Nëse iu referohemi të dhënave nga

terreni atëherë del se sektori i ndërtimtarisë dhe sektori i gastronomisë kanë më tepër punëtorë të padeklaruar", ka thënë ai. Ai ka treguar numrin e përgjithshëm të punëtorëve të

deklaruar aktualisht në tregun e Kosovës. "Sipas të dhënave të muajit korrik, i kemi mbi 405 mijë punëtorë të raportuar, rreth 15 mijë më shumë sesa gjatë muajit korrik të vitit të kaluar", ka pohuar Murtezaj.

Në Prishtinë nis fushata kundër sëmundjes së kancerit të gjirit

Prishtinë, 27 gusht- Komuna e Prishtinës ka hapur fushatën vetëdijesuese kundër sëmundjes së kancerit të gjirit "Race for the Cure Prishtina 2023".

Me këtë rast foli kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, i cili u bëri thirrje të gjitha grave të kryejnë kontrolle dhe të bëjnë mamografi, pasi tashmë janë aparaturat e nevojshme dhe se nuk kanë nevojë të presin për radhë. Po ashtu, edhe drejtori i

Drejtorisë së Shëndetësisë, Izet Sadiku u shpreh se janë duke punuar vazhdimisht në përmirësimin e kushteve për t'i ndihmuar gratë në parandalimin dhe kurimin e kancerit të gjirit.

Ndërkaq, udhëheqësja e organizatës joqeveritare "Renesansa", Violeta Pirana tha se po të angazhohemi së bashku, mund të bëhen mrekulli në luftimin e kësaj sëmundje, derisa shtoi se me hapjen e kësaj fushate, po

hapim dyert për ndërgjegjësimin dhe rritjen e fondeve kundër kësaj beteje të pazakontë.

Po ashtu, edhe udhëheqësja e aktiviteteve kundër kancerit të gjirit dhe njëkohësisht bashkëshortja e të parit të Prishtinës, Kristale Ivezaj Rama falënderoi të gjithë ata që kontribuuan dhe u bënë pjesë e kësaj kampanje kundër sëmundjes së kancerit të gjirit.



Mazreku: Ka vetëm një pengesë që e lë Kosovën jashtë “Kartonit të Gjelbër”

PRISHTINË, 27 GUSHT - Mosanëtarësimi në OKB paraqet pengesën kryesore të anëtarësimi të Kosovës në Këshillin e Byrove Evropiane. Rrjedhimisht vendi ynë vazhdon ta ketë të pamundur të jetë pjesë e sistemit të Kartanit të Gjelbër. Kështu tha për Radio Kosovën drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, BKS, Sami Mazreku, i cili konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet teknike nga ana e Kosovës. “Byroja e Kosovës i ka të rezervuara rreth 7 milionë euro edhe pse kjo shumë është më e madhe se ajo që kërkohet nga Këshilli i Byrove, mirëpo duke qenë se nuk jemi pjesë e OKB-së nuk po mundemi të bëjmë zgjidhje për sa i përket Kartanit të Gjelbër”, tha ai. Mazreku tha se është tentuar përmes një shteti tjetër për të qenë pjesë e sistemit të Kartanit të Gjelbër, por nuk



ka qenë e mundur për shkak të problemeve politike. “Ne kemi tentuar përmes një shteti tjetër mirëpo Këshilli i Byrove po thotë ju keni probleme politike”, theksoi

ai. Sipas Mazrekut, Kosova në këtë mënyrë mbetet vendi i vetëm në Evropë që nuk është anëtare e Këshillit të Byrosë Evropiane, edhe pse i ka plotësuar kushtet teknike. “Duke qenë se Kosova është shtet i ri dhe ka probleme me mosnjohje nga disa shtete përreth po ashtu ka probleme politike të cilat nuk e kanë mundësuar që Kosova të jetë pjesë e OKB-së. Ne jemi angazhuar që gjatë këtyre dy viteve ato që janë teknike t’i plotësojmë”, tha ai. Mazreku më tej tha se tashmë janë duke pritur një raport nga Këshilli i Byrove. Ai tha se duhet gjetur ndonjë variant tjetër për të qenë pjesë e këtij Këshilli. Kartoni i Gjelbër është një certifikatë ndërkombëtare e sigurimit të automjeteve, e cila pranohet nga autoritetet e të 47 vendeve, ku Kartoni i Gjelbër është i vlefshëm.

Mërgata vazhdon me rekordin e remitencave, për shtatë muaj u sollën mbi 80 milionë euro më shumë në Kosovë

PRISHTINË, 27 GUSHT- Pavarësisht krizës ekonomike botërore të shkaktuar nga agresioni ushtarak rus në Ukrainë që nga shkurti i 2022-s, mërgata vazhdon të kontribuojë në dërgimin e parave për familjet e tyre në Kosovë. Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovë (BQK) mbi dërgesat nga jashtë, tregojnë se nga muaji janar në korrik 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, diaspora jonë ka dërguar 81.5 milionë euro më shumë. Për këtë periudhë, vlera më e lartë ishte gjatë muajit maj me 126.6 milionë euro nga totali prej mbi 751.8 milionë euro. Duke iu referuar kanaleve të dërgimit, BQK-ja thotë se, 429.6 milionë euro janë transferuar me anë të agjencive të dërgesave të parëve, kurse pjesa tjetër me anë të bankave komerciale dhe kanaleve alternative, raporton Telegrafi. Sa i përket dërgesave të mërgatës sipas vendeve, Gjermania është shteti ku më së shumti dërgohen para në drejtim të Kosovës. Nga ky vend kanë ardhur 37.4 për qind e dërgesave, ndjekur nga Zvicra me 18 për qind, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 7.4 për qind, Austria me 4.9 për qind dhe Italia me 4.5 për qind. “Ngadalësimin e rritjes së konsumit e ka ndikuar kryesisht rënia e fuqisë blerëse të konsumatorëve, për shkak

të rritjes së çmimeve, ndërkohë që burimet kryesore të financimit si remitencat, kreditë e reja konsumuese, konsumi publik, etj., shënuan rritje”, thuhet në raportin e BQK-së për vlerësimin tremujor të ekonomisë. Vlera e remitencave të pranuar në tremujorin e parë të 2023-së kanë shënuar rritje prej 12.4 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e remitencave sipas shteteve mbetet e pa ndryshuar: Gjermania që ka një pjesëmarrje prej 38.8 për qind të remitencave të dërguara, ndjekur nga Zvicra me 17.2 për qind dhe ShBA-ja me 7.6 për qind”, vijon raporti “Vlerësimi tremujor i ekonomisë, tremujori i parë 2023”. Sipas BQK-së, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë mund të ketë pasur ndikim mbi këto dërgesa, si një e hyrë për ekonominë e vendit tonë. “Duke konsideruar që pjesa me e madhe e remitencave të pranuar kanë origjinë vendet e Eurozonës apo 57.2 për qind e totalit, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë mund të ketë implikime mbi këtë të hyrë për ekonominë e Kosovës”, përfundon BQK-ja. Ndërsa, Banka Botërore thotë se pjesëmarrja e remitencave në Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Kosovës është



rreth 20 për qind, ku nga shpallja e pavarësisë janë dërguar rreth 13 miliardë euro. Shuma e remitencave të dërguara sipas viteve në Kosovë: 2008 - 858 milionë euro, 2009 - 865 milionë euro, 2010 - 825 milionë euro, 2012 - 775 milionë euro, 2013 - 867 milionë euro, 2014 - 901 milionë euro, 2015 - 796 milionë euro, 2016 - 808 milionë euro, 2017 - 911 milionë euro, 2018 - 1.13

miliard euro, 2019 - 1.23 miliard euro, 2020 - 980 miliard euro, 2021 - 1.14 miliard euro dhe 2022 - 1.2 miliard euro. Për sa i përket vizitës së diasporës në vend, Në gjashtë muajin e parë të vitit 2023, duke e shfrytëzuar Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” kanë ardhur dhe shkuar mbi 1.5 milion mërgimtarë. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar mbi 10,400 fluturime, ku numri më i madh është nga Zvicra, ndjekur nga

Gjermania, Turqia dhe Austria. Numër më i madh i ardhjes dhe shkuarjes së mërgimtarëve është realizuar gjatë muajve prill dhe maj, ku kanë ardhur në total 586,157 udhëtarë me 4,040 fluturime. Nga rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës, të cilët i janë përgjigjur regjistrimit është rreth 350 mijë.

a

Nga Azem SYLA, ish-komandant i përgjithshëm i UÇK-së

(Disa kujtime shumë të vërteta dhe reale dhe mendime e vlerësime për veprimtarin e çështjes kombëtare të shqiptarëve nën Jugosllavi – Serbi, Abdyl Krasniqi nga Drenoc i Malishevës)





U krijua pas zbulimit në 1969. Si funksionon “Fondi i Naftës” i Norvegjisë



Fondi Qeveritar Global i Pensioneve u krijua pasi Norvegjia zbuloi naftë në Detin e Veriut. Fondi u krijua për të mbrojtur ekonominë nga ulje-ngritjet e të ardhurave nga nafta. Ai shërben gjithashtu si një rezervë financiare dhe si një plan kursimi afatgjatë, në mënyrë që brezi aktual dhe i ardhshëm i Norvegjisë të përfitojnë nga pasuria e naftës.

Në vitin 1969, një nga vendburimet më të mëdha të naftës në botë në det të hapur u zbulua në Norvegji. Papritur, shteti nordik kishte shumë naftë për të shitur dhe ekonomia e tij u rrit në mënyrë dramatike.

Qysh herët, u vendos se të ardhurat nga nafta dhe gazi duhet të përdoren me kujdes për të shmangur çekuilibrat në ekonomi. Në vitin 1990, parlamenti

norvegjez miratoi legjislacionin për ta mbështetur këtë ide, duke krijuar atë që sot është Fondi Qeveritar Global i Pensioneve, dhe paratë e para u depozituan në fond në vitin 1996. Siç sugjeron emri, u vendos që fondit të investohej vetëm jashtë vendit.

Të ardhurat nga nafta kanë qenë shumë të rëndësishme për Norvegjinë, por një ditë nafta do të mbarojë. Qëllimi i fondit është të sigurojë që ato para të përdoren me përgjegjësi, dhe kështu të mbrohet e ardhmja e ekonomisë norvegjeze.

Si rritet fondit?

Megjithëse të ardhurat nga prodhimi i naftës dhe gazit transferohen në fond, këto depozita përbëjnë më pak se gjysmën e vlerës së tij. Pjesa

më e madhe është fituar nga investimi në aksione, të ardhura fikse, pasuri të paluajtshme dhe infrastrukturë të energjisë së rinovueshme.

Sot, ai është një nga fondet më të mëdha në botë, duke zotëruar pothuajse 1.5 për qind të të gjitha aksioneve në kompanitë e listuara në bursë botë. Kjo do të thotë se ne Fondi ka aksione në rreth 9,000 kompani në mbarë botën, duke i dhënë të drejtën për një pjesë të vogël të fitimeve të tyre çdo vit.

Përveç kësaj, fondit zotëron qindra ndërtesa në disa nga qytetet kryesore të botës, të cilat gjenerojnë të ardhura nga qiraja.

Fondi gjithashtu merr një fluks të qëndrueshëm të ardhurash nga kreditimi për vendet dhe kompanitë e ndryshme. Duke i përhapur gjerësisht investimet, është

zvogëluar rreziku i humbjes së parave të fondit.

Si shpenzohen kursimet

Çdo vit, qeveria norvegjeze mund të shpenzojë vetëm një pjesë të vogël të fondit, por kjo është gjithësesi pothuajse 20 për qind e buxhetit të qeverisë.

Ekziston një konsensus i gjerë politik se si duhet të menaxhohet fondit. Sa më pak të shpenzohet sot, aq më mirë do të jetë Norvegjia në pozicionin për t'u përballur me rëniet ekonomike dhe krizat në të ardhmen.

Tepricat buxhetore kalojnë në fond, ndërsa deficitet mbulohen me para nga fondit. Me fjalë të tjera, autoritetet mund të shpenzojnë më shumë në kohë të vështira dhe më pak në kohë të mira. Në mënyrë që nga fondit të përfitojnë sa më shumë

njerëz që të jetë e mundur edhe në të ardhmen, politikanët kanë rënë dakord për një rregull fiskal që siguron që të mos shpenzohet më shumë se të ardhurat e pritshme në fond.

Mesatarisht, qeveria duhet të shpenzojë vetëm ekuivalentin e të ardhurave reale në fond, i cili vlerësohet të jetë rreth 3 për qind në vit. Në këtë mënyrë, të ardhurat nga nafta kalojnë gradualisht në ekonomi. Në të njëjtën kohë, shpenzohet vetëm të ardhurat vjetore të fondit, dhe jo kapitali i tij.

Roli i fondit është të sigurojë që pasuria kombëtare të zgjasë për aq kohë sa të jetë e mundur. Investimet e saj kanë një perspektivë jashtëzakonisht afatgjatë, duke i mundësuar të përballojë luhatjet e mëdha në vlerë në afat të shkurtër. / *bota.al*

Jeta dhe fati (i paralajmëruar) i kuzhinierit të Carit

E vetëm sot kuptohet se sa dëshpërim kishte në atë gjest ekstrem.

Sepse nëse do të kishte një person që e njihnte mirë presidentin rus, ishte ai, ish i dënuari dhe ish-shitësi i hot dog-ëve, i cili u rrit gjithashtu në rrugicat e Shën Petersburgut kaq të rëndësishëm për formimin personal të Carit, të cilit i detyrohej gjithçka. Prandaj ai e dinte se kishte njëfarë të vërtete në atë që vëzhguesit rusë dhe perëndimorë pohuan në unison, në marrëveshje, secili me formula të ndryshme, duke i dhënë atij edhe pak kohë në liri ose në jetë.

Mediat më të afërta me Kremlinin bënë thirrje për “dënime shembullore”, emisionet propagandistike të cilat disa muaj më parë lavdëronin “pushtuesin e Bakhmutit”, tashmë i portretizonin atë dhe njerëzit e tij si tradhëtarë, ose një “biznesmen me të kaluar kriminale, një biznesmen në hije” duke ngritur pyetjen, pse ai ishte ende i lirë.

“Prigozhinit dhe udhëheqësve të Wagnerit duhet t’u pritët koka,” thoshte deputeti i Ruisë së Bashkuar Andrey Gurulyov, një ish-ushtar i konsideruar besnik i presidentit. Të gjithë në Rusi e dinin se Putini nuk mund të anashkalonte kurrë një gjë si ajo që kishte vuajtur para syve të gjithë botës. Nuk do i shkonte imazhit të tij si Car, si një njeri që nuk lë punë të papërfunduar, si një lider që vendos dhe që nuk bën kompromise nga frika, si ai që dukej se kishte firmosur me Prigozhinin për të ndaluar ushtrinë e tij dyqind kilometra nga Moska.

Historia e vonë e Ruisë duhet t’i kishte mësuar diçka. Por ndoshta komandanti i Wagnerit besoi tek vetja, dhe tek ajo çfarë mbeti nga lidhja e tij me Putinin. Sapo hyri në moshë, ai u arrestua për krim të organizuar, vjedhje, mashtrim dhe shfrytëzim prostitucioni të të miturve. Hyni në burg në 1982 kur Leonid Brezhnevi ishte ende gjallë, doli në vitin 1990 kur Bashkimi Sovjetik ishte në prag të kolapsit. Rusët i kujtojnë si vitet e tmerrshme vitet ’90, por për njerëz si ai ato ishin një mundësi.

Filloi në një kioskë hot-dogësh



në bashkëpronësi me një dajë. Pesë vjet më vonë, me fonde ende të panjohura, themeloi vetë kompaninë e restoranteve Concord, e cila do të mbetet gjithmonë guri i themelit të mbretërimit të tij, duke hapur një restorant ku darkonin dhe drekonin kryetari i bashkisë së Shën Petersburgut Anatoly Sobchak dhe zëvendësi i tij, një i ri me emrin Vladimir Putin. Kur ky i fundit u bë kreu i qeverisë dhe më pas president, restorantet e Prigozhinit u zgjodhën për darkat zyrtare me krerët e shteteve të huaja, që nga Zhak Shirak e deri te Xhorxh Bush.

Thuhet se Putini e ka vlerësuar faktin që Prigozhini shpesh shërbente në tavolina personalisht. Fakti është se në vitin 2009 Concord mori kontratën për mensat shkollorë të qyteteve më të mëdha ruse, dhe tre vjet më vonë atë ekskluzive për furnizimin me ushqim të Ushtrisë e Kuqe. Miliarda rubla, dhe pseudonimi “kuzhinieri i Putinit”.

Në vitin 2014, gjithçka ndryshoi. Në janar, Prigozhini themeloi një agjenci kërkimore në internet në Shën Petersburgun e tij që do të bëhet më e famshme si “fabrika e trolleve”, e cila do të lejonte Kremlinin të helmonte ujërat e internetit derisa të ndikonte në zgjedhjet amerikane të vitit 2016. Në verë, gjatë pushtimit të Donbasit, i kërkoi Ministrisë së Mbrojtjes tokë për stërvitjen e “vullnetarëve” pa lidhje me ushtrinë zyrtare, por të etur për të dhënë kontributin e tyre për atdheun kudo që ka një skenar luftime. Milicia e porsalindur do të quhet Wagner.

Është pseudonimi që i është vënë komandantit të saj të parë, Dmitry Utkin, njeriu që është konsideruar gjithmonë shpirti i grupit, ideologu që jepte shpërblime dhe ndëshkime mizore, ish oficeri i Forcave Speciale që u transferua në sektorin privat, një nazist i cili deklaroi se dy muaj më parë ishte kthyer nga

një lloj pensioni për të drejtuar personalisht të ashtuquajturin Marshimi për Drejtësi.

Ndodhej edhe ai në aeroplanin që u rrëzua në zonën e Tverit. Dhe nëse vdekja e një njeriu të frikshëm, por të padashur si Prigozhini ka një vlerë të madhe simbolike në sytë e Perëndimit, ajo e Utkinit mund të ketë pasoja më të mëdha brenda Ruisë, sepse ndër ultranacionalistët më fanatikë emri i tij ishte vërtet një legjendë.

Këto tetëmbëdhjetë muaj luftë ishin fatale për Prigozhinin. I ka jetuar gjithmonë në publik, si për të pretenduar një rol që e ndjente se i takonte. Pas vitesh mohimi se kishte lidhje me krijesën e tij, më 7 maj 2022 ai regjistroi një video në të cilën paraqitej i veshur me kamuflazhin e mercenarëve të tij. Është një kreshendo e vazhdueshme. Fillimisht ekzekutimet e drejtpërdrejta të dezertorëve, buletinet nga fronti, propaganda e bërë vetëm në emër të tij, më pas tiradat gjithnjë e më të

shpeshta kundër “hajdutëve dhe burokratëve” të Ministrisë së Mbrojtjes, “fajtorë” se janë tepër të butë ndaj Kievit. Figura e tij bëhet gjithnjë e më e rëndë.

Në fillim, pak njerëz brenda dhe jashtë vendit parashikuan një përballje kaq brutale. Për afërsinë me Putinin, dhe mbi të gjitha sepse e kemi të vështirë të pranojmë se kundërshtimi më i fortë ndaj Kremlinin ka ardhur nga ata që donin më shumë luftë, jo nga ata që donin më pak.

Por më në fund u bë e qartë se hesapet do laheshin gjithsesi. Putini kishte vendosur të shpërndante Wagnerin. Më 23 qershor, Prigozhini u nis drejt Moskës, duke sfiduar Carin e tij në publik, duke e bërë atë të duket i dobët jo vetëm në sytë e botës, por edhe të popullit të tij, gjë që është shumë më serioze dhe e pafalshme. Ajo që ndodhi mes asaj kohe dhe ditës së djeshme ka pak rëndësi. Ishte thjesht çështje kohe. / Corriere della Sera – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Llapi fiton me përmbysje ndaj Fushë Kosovës, Prishtina merr kryesimin



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Skuadra e Llapit me përmbysje ka arritur të shënon fitore në përballje me skuadrën e Fushë Kosovës (2-1), në ndeshjen e javës së tretë në Superligën e futbollit. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan solli mjaftë emocione dhe tri gola. Ishte skuadra e Fushë Kosovës kaloi në epërsi pas gjysmë ore loje, me goli e kapitenit Arben Krasniqi. Por, skuadra e Llapit nuk u dorëzua dhe bëri përmbysje të mrekullueshme në pjesën e dytë. Ilir Blakçori barazoi shifrat në minutën e 49-të. Në minutën e 76-të, Muhamet Hyseni shënoi golin e fitores për Llapin. Ndërsa ndeshja e zhvilluar në stadiumin "18 Qershori" në Klinë nuk solli fitues, pasi Dukagjini dhe Liria kanë luajtur baras 0-0. Rastet nuk munguan, por asnjëra

skuadër nuk arriti të shënon gol. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje tjera ku Prishtina ka shënuar fitore ndaj skuadrës në topformë Malishevësme rezultat 3-1. Ndeshja e zhvilluar në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali është mbyllur me fitoren e kryeqytetasve. Prishtina shënoi pas njëmbëdhjetë minutave lojë me anë të Leotrim Kryeziut nga penalltia. Epërsinë në 2-0 e shtoi Drilon Islami në minutën e 38-të. Pjesa e parë përfundoi me rezultat 2-0. Në minutën e 63-të, Hasan Hyseni realizoi pas një asistimi të Jalen Blesas. Golin e vetëm për malishevasit e shënoi Robert Mathieu Ndjigi. Fitores iu gëzua edhe skuadra e Feronikelit 74, e cila e mposhti Gjilanin me rezultat minimal 1-0. Golin e fitores për skuadrën nga Drenasi e shënoi Shpresim Zogu, në minutën e 86-të. Për Feronikelin 74 kjo ishte fitorja e parë pas rikthimit në elitë. Ndeshja derbi mes Dritës dhe Ballkanit

është shtyrë pasi skuadra kampionia në fuqi është e angazhuar në Ligën e Konferencës ku do të zhvillojë ndeshjen kthyesë kundër BATE Borisov.

SUPERLIGA	
Drita-Ballkani (U shty)	
Fushë Kosova - Llapi	1-2
Dukagjini - Liria	0-0
Prishtina - Malisheva	3-1
Feronikeli 74 - Gjilani	1-0
Tabela	
1. Prishtina	7 pikë
2. Malisheva	6
3. Ballkani	6
4. Llapi	6
5. Drita	4
6. Feronikeli 74	3
7. Liria	2
8. Gjilani	1
9. Dukagjini	1
10. Fushë Kosova	0

SHKURT

Presidenti i Clujit: Krasniqi do të largohet

Largimi i Ermal Krasniqit nga skuadra rumune Cluj duket se është çështje e kryer tashmë. Kështu ka bërë të ditur presidenti i skuadrës, Nelu Varga i cili ka thënë se për lojtarin kanë arritur tri oferta shumë serioze. Varga ka treguar se ka tre oferta për Krasniqin, një nga Franca, një nga Gjermania dhe një nga Italia. Krasniqi raportohej se kërkohet nga Bordeaux, i cili luan në Ligue 2 franceze, ku luan edhe Alexi Pitu. "Kemi tre oferta për Krasniqin për momentin. Një nga Franca, një tjetër nga Gjermania dhe një tjetër nga Italia. Largohet 99% për një shumë mbi 5 milionë euro. Negociatat janë avancuar, ai është një lojtar shumë i mirë, top", ka zbuluar Nelu Varga për "iAMsport.ro".

Juve gabon ndaj Bolognas

Ndeshja mes Juventusit dhe Bolonjës e vlefshme për javën e dytë të Seria A është mbyllur me rezultatin 1-1. Miqtë kaluan në avantazh në minutën e 24-të me Ferguson ndërsa barazimi erdhi vetëm në të 80-ën me Vlahoviç. Kështu bardhezinjtë hedhin një hap fals teksa renditen në vendin e 4-të me 4 pikë.

Bayerni fiton, Kane shënon dy gola

Bayern Munchen ka shënuar fitore ndaj Augsburgut, me rezultat 3-1, në kuadër të xhiros së dytë në Bundesliga. Felix Uduokhai realizoi autogol në minutën e 32', për t'ia dhënë epërsinë klubi gjerman. Ndërsa Harry Kane me një gol në minutën e 40', i dërgoi skuadrat në pushimin në mes dy pjesëve. Në pjesën e dytë, Kane realizoi edhe një herë tjetër, në minutën e 69'. Golin e vetëm për Augsburgun e realizoi Belje, në minutën e 86'. Bayerni pas ndeshjeve renditet në vendin e dytë me gjashtë pikë.

Fitojnë Liverpooli dhe City

Liverpooli merr një fitore spektakolare 1-2 ndaj Newcastle në "St. James's Park", një ndeshje që kanë luajtur thuajse me një lojtarë më pak. Vendasit e nisën vullshëm dhe morën avantazhin në minutën e 25-të, kur pas një gabimi të Aleksander-Arnold, ishte Anthony Gordon që shënoi në portën e Alisson. Vetëm tri minuta më vonë Van Dijk u ndëshkua me karton të kuq për një faull ndaj Wilson. Megjithatë Liverpooli rezistoi dhe në fund Klopp zgjidhi gjithçka me aktivizimin e Darwin Nunez. Sulmuesi shënoi dy herë në portën e Newcastle, duke kompletuar përmbysjen dhe duke i dhënë 3 pikët Liverpoolit. Fitore ka shënuar edhe Manchester City ndaj Sheffield United (1-2).

Gega e mbyll Botërorin në vendin e tetë

Budapest, 27 gusht - Nuk ka mrekulli në Botërorin e Atletikës, por Luiza Gega mbetet krenari. Pavarësisht dëmtimit, Gega nuk stonoi në garën e 3000 metra me pengesë, duke u renditur në vendin e tetë. Atletja kuqezi e mbylli garën e sajë me kohën 9 minuta, 10

sekonda, 27 të qindtat. Kjo është koha më e mirë sezonale e atletes shqiptare, duke humbur vendin e shtatë për vetëm 1 të mijtat më shumë se rivalja nga Uganda. Gjatë finales, atletja kuqezi ishte përgjatë gjithë kohës mes rivaleve më të mira, ndërkohë që në

mesin e garës humbi terren nga kreu. Në fund arrin të rikuperojë disa pozicione, duke dalë e teta, ndonëse synonte vendin e shtatë. Në këtë botëror, për Shqipëria garoi edhe Franko Burraj, në garën e 200 metrave por pa mundur të avancojë më tej.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 678 /1
Datë: 25.08.2023

SHPALLJE KONKURSI

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së gjashtë për nivelin e 5-të të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” në: 1) Gjilan dhe komunat: Kamenicë, Viti & Novorbë, dhe) & 2) Gjakovë dhe komunat: Rahovec, Klinë, Deçan dhe Junik. për vitin shkollor 2023/2024

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve

Për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, për vitin shkollor 2023/2024, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë dhe janë më të vjetër se 18 vjeç.

Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Të drejtë aplikimi kanë:

- 1.1 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).

2. Ofrimi i kualifikimit

Në këtë vit shkollor, kualifikimi do të ofrohet në 2 grupe:

- 1) Në një Institucion Arsimor në Gjilan, dhe
- 2) Në një Institucion Arsimor në Gjakovë.

Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Ferizaj si Institucion i akredituar nga PEARSON.

3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me diplomë sipas standardeve të BTEC.

4. Kreditë

Kualifikimi për “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” zgjat një vit shkollor dhe vlerësohet me 1200 orë të Arsimit dhe Aftësimin Profesional.

5. Pagesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 15 ditëve pasi të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 320 (treqind e njëzet) Euro.

6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Fletëparaqitjen e cila merret në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr);
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë diplomuar pas vitit shkollor 2015/2016;
- ✓ Certifikatën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin e mesëm të lartë para vitit shkollor 2014/2015;
- ✓ Certifikatën e vendbanimit;
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 28 gusht deri 08 shtator 2023.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.30.

Kandidatët do të ftohen për testim online me datë: 20 shtator 2023

Për vendin e mbajtjes së testimit do të njoftoheni përmes email-it.

Rezultatet e testit të kandidatëve shpallen në AAAPARr, Prishtinë me datën 27. 10. 2023 dhe dergohen me email të kandidatët.

Kthimi i dokumenteve (orgjinali), për kandidatët të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 02 deri 05 tetor 2023, pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në AAAPARr.

8. Kriteret e regjistrimit

Kandidatët që vlerësohen në bazë të rezultateve të testit, do të pranohen sipas radhitjes të pikëve maksimale për secilën komunë.

9. Kuotat për pranim të kandidatëve sipas komunave

Do të pranohen gjithsejt 50 kandidat.

Me qëllim që komunat e regjionit të Gjilanit dhe Gjakovës të mbulohet me kadro të kualifikuara për këtë kualifikim, për këtë vit shkollor, MASHTI ka vendosur kuotat e pranimit të kandidatëve si në tabelën në vijim.

Nr	Komuna	Kuota	Nr	Komuna	Kuota
1	Gjilan	15	2	Gjakovë	15
1.1	Kamenicë	4	2.1	Rahovec	3
1.2	Viti	4	2.2	Klinë	3
1.3	Novobërd	2	2.3	Deçan	2
			2.4	Junik	2

